



Thirrje publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve në fushën e profilizuar në Art dhe Kulturë

1. Zyra e Kryetarit të Komunës së Gjakovës, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i profilizuar në fushën e Artit dhe Kulturës, me fokus në organizimin dhe realizimin e koncerteve orkestrale në mënyrë profesionale në shënimin e ngjarjeve me rëndësi që lidhen me aktivitete kulturore, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve në fushën e Artit dhe Kulturës.

2. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në promovimin e muzikës klasike dhe bashkëkohore si dhe jetën kulturore në komunën e Gjakovës, me qëllim të përmbushjes së nevojave kulturore – muzikore të audiencës së gjerë përmes zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve me kushtet si më poshtë:

- a. Organizata duhet të ketë orkestër të angazhuar të traditës perëndimore artistike dhe reviale, minimalisht 25 anëtarë profesionist me përvojë në fushën e muzikës artistike.
- b. OJQ duhet të ketë kontakte dhe marrëveshje me artistë të mirënjohur global ose rajonal.
- c. Duhet të sigurojë kontrata të parakohshme me performues të mëdhenj për të garantuar pjesëmarrjen e tyre.
- d. Të ketë marrëveshje me një kompani për ofrimin e shërbimeve për shpërndajen online të biletave , organizimin dhe menaxhimin e publikut.
- e. Duhet të ketë një plan të detajuar për menaxhimin e emergjencave, duke përfshirë evakuimin, kontrollin e hyrjeve dhe masat kundër trazirave.
- f. OJQ duhet të bashkëpunojë me autoritetet për të siguruar nivelin më të lartë të sigurisë për pjesëmarrësit.
- g. Organizata duhet të tregojë aftësinë për të promovuar eventin në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për të tërhequr audiencë më të gjerë.
- h. Duhet të ketë përvojë në projekte ku integrohen grupet e marginalizuara.

- i. Përveç masave standarde të sigurisë, OJQ-ja duhet të sigurojë një ekip mjekësor të certifikuar, pajisje emergjente dhe një sistem monitorimi shëndetësor në kohë reale për pjesëmarrësit.
- j. OJQ për organizimin e eventit duhet të marrë parasysh aksesin për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë përkthim në gjuhën e shenjave, shtigje të aksesueshme për karriget me rrota dhe hapësira të dedikuara për audiencën me nevoja të veçanta.
- k. Përveç eventeve muzikore, OJQ duhet të ketë përvojë në organizim e konferencave me panelistë ndërkombëtarë, liderë të industrisë së muzikës dhe ekspertë të politikave kulturore për të diskutuar trendet dhe sfidat e sektorit.

3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 13.000 euro. Për OJQ-të të cilat aplikojnë me projekte për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një (1) projekt është 500 euro, ndërsa shuma maksimale për një (1) projekt është 13.000 euro.

4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën **19.03 2025**.

5. OJQ-të mund të aplikojnë ose të jenë partner në më së shumti vetëm me një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje.

6. Periudha e zbatimit të projektit është për 12 muaj. OJQ mund të përfshihet më së shumti në një (1) projekt dhe të përfshihet në zbatimin e vetëm një (1) fushe prioritare.

7. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në ndonjërin nga llojet e fushës dhe aktiviteteve të përfshira në kuadër të kësaj thirrje publike.

8. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare.

11. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të, duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

12. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komuna e Gjakovë / Zyra e Kryetarit (<https://gjakova.rks-gov.net/>)

13. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në Adresa: Rr. “UÇK” p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës/ Zyra e Kryetarit”.

14. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

15. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
16. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në zyrën e Kryetarit.